

ANEKS NR. 5
PËR PUNONJËSIT ME KONTRATË TË PËRKOHSHME

Për kontraktimin e punonjësve me kohë të pjesshme mbi numrin organik të punonjësve të institucioneve buxhetore për vitin 2024, ndiqen këto rregulla:

1. Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme miratohet nga Këshilli i Ministrave nëpërmjet propozimit të Ministrisë përgjegjëse për Financat.
2. Institucioni duhet të ketë fondet e nevojshme për mbulimin e shpenzimeve të personelit të kontraktuar.
3. Veprimtaria që kryejnë punonjësit me kontratë është kryesisht veprimtari e njësive strukturore mbështetëse/rregullatore/shërbimi të institucionit dhe në asnjë rast veprimtari inspektuese apo audituese.
4. Kontraktimi i punonjësve bëhet në përputhje me kriteret e parashikuara për atë pozicion pune, për një periudhë kohore deri në 6 muaj gjatë një viti buxhetor me kohë pune ditore të plotë, ose deri në 6 orë në ditë përgjatë vitit buxhetor. Përfundim nga ky përcaktim, bën kontraktimi i punonjësve që kryejnë një veprimtari që realizon të ardhura dytësore, përdorimi i të cilave parashikohet në ligjin vjetor të buxhetit, për këtë qëllim.
5. Pagesa e punonjësve me kontratë të përkohshme, përcaktohet në referencë të vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave, për pozicionin për të cilin ai kontraktohet. Për pozicionin “Specialist”, paga e punonjësit me kontratë të përkohshme në institucionet e pavarura dhe aparatet e ministrive nuk kalon nivelin e kategorisë IV-2 dhe në institucionet në varësi të tyre, nivelin e kategorisë IV-3. Në rast se pozicioni ka shtesa specifike mbi pagën e kategorisë/klasës përkatëse, ato nuk përfitohen nga punonjësi me kontratë të përkohshme, me përjashtim të shtesës mbi pagë për punë të vështira e të dëmshme për shëndetin.
6. Rregullat përjashtimore për punonjësit me kontratë të përkohshme të Kryeministrit, përcaktohen në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave.
7. Pagesa bëhet në përputhje me procedurat e kryerjes së pagesave për punonjësit organik dhe përfshihet në shpenzimet e personelit të institucionit. Përfundim nga ky rregull, bëjnë anketuesit/kontrollorët e terrenit të kontraktuar në realizimin e Censur-it dhe anketimeve afatshkurta (më pak se dy javë) si dhe operatorët teknik për përdorimin e pajisjeve të teknologjisë së informacionit në qendrat e votimit, pagesa e të cilëve e bazuar në ditët e punës, do të përfshihet në shpenzimet operative të institucionit.
8. Në raste specifike që lidhen me mësimdhënien, veprimtarinë bujqësore, veprimtarinë statistikore, rregullat dhe procedurat e marrjes në punë të punonjësve me kontratë përcaktohen nëpërmjet udhëzimit të përbashkët të miratuar mes institucionit qendror përgjegjës dhe ministrisë përgjegjëse për financat.